REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E KULTURËS

Nr.3778 prot Maliq, më 22.6.2026

PROJEKT VENDIM

PËR AKTIVITETIN KULTUROR « FESTA E MADHE E KËNGËS »

Në mbeshtetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015"Për vetëqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, neni 25 " Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese",ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", të ligjit Nr 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" , Udhëzimit plotësues nr 2 datë 14.01.2025"Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2026",mbështetur në vendimin Nr 148 datë 24.12.2025 të Këshillit Bashkiak Bashkia Maliq "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2026", ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", ligjit nr. 25/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën" dhe VKM nr.1173, datë 6.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e Qeverisjes Qëndrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", kërkojmë nga ana juaj :

1- Miratimin për mbështetje finaciare prej 1.000.000 (një milion) lek,për aktivitetin artistik.
2- Miratimin e datës të aktivitetit 27 korrik 2026.
3- Marëveshja për realizimin e aktivitetit do të bëhet midis Bashkisë Maliq dhe Shoqatës Artistike Kulturore 'PROMOTOR'.
4- Financimi i Projektit do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Kulturës.

Preventiv

LLoji I shpenzimit	Njësi	Çmim	Total
Këngëtarë pjesmarrës	10	70,000	700,000
Staf realizues	10	30,000	300,000
Totali			**1,000,000**

DREJTORI I DREJTORISË

Dhora Shkëmbi

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E KULTURËS

Maliq më 22/6/**2026**

3778

RELACION

Për aktivitetin Artistik MARATONA "Festa e Madhe e Këngës"2026.

Me inicjim dhe nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Maliq **Z.GëzimTopçiu**, për ti dhënë jetë, gjallëri dhe kënaqësi publikut të gjërë të bashkisë, mendojmë qe të zhvillojmë aktivitetin artistik, **MARATONA** "Festa e Madhe e Këngës" 2026.

Ky aktistik bazohet në interpretimin e këngës popullore nga trevat e gjithë Shqipëtarëve Brenda dhe jashtë kufirit shtetëror, një BIG SHOW i cili është organizuar ekskluzivisht për shumë vjet nga shoqata "**PROMORTOR**" dhe që është një festë e madhe muzikore. Tashmë ky eveniment është kthye rnë një traditë të mirëfilltë për shumë bashki në qytetet e ndryshme të Shqipërisë .

Në boshtin e këtij projekti është muzika argëtuese, kryesisht hitet e reja të muzikës së mire Shqipëtare, por spektakli duke qënë një manifestim i vlerave muzikore, artistike kulturore do ti tejkalojë dimensionet e këngës.

Hapësirë të rëndësishme ka trashëgimia e vlerave risjellë me tendencat e konceptet bashkëkohore. Për të sjellë këtë brume muzikor gjithmonë në të marin pjesë artistët dhe personazhet më të spikatur të këngës. Spektakli është eveniment artistic i mirëfilltë, evokim i vlerave muzikore Shqipëtare, por edhe homazh për figurat e mëdha të kësaj tradite.

Ky event do të jetë falas për publikun dhe do të performojë datën 27 Korrik 2026, në bulevardin "Rinia" të qytetit të Maliqit .

DREJTORI I DREJTORISË

Dhora **SHKEMBI**

Shoqate Kulturore Artistike
Rr.e Elbasanit Pall . ABAU
Tirane,Shqiperi
Email: shoqatapromotor@gmail.com

Drejtuar: Bashkisë Maliq
Zotit : Gëzim Topçiu, kryetar i Bashkisë
Lënda: Kërkesë për realizimin e Projektit "Maratona Festa e Këngës" 2026

I nderuar zoti Kryetar,

Duke ju uruar punë të mbarë në projektet dhe angazhimet tuaja të rëndësishme në drejtimin e bashkisë Maliq si dhe duke ju falenderuar ju dhe Bashkinë që përfaqësoni për bashkëpunimin e deritanishëm në realizimin e aktiviteteve të ndryshme, parashtrojmë kërkesën tonë për realizimin e evenimentit të madh veror prej shumë vjetësh "Maratona Festa e Këngës" 2026 që është produksion i shoqatës sonë, me pjesëmarrjen e artistëve më të spikatur të muzikës shqiptare për një kohëzgjatje rreth 120 minuta si dhe me gjithë teknikën e nevojshme bashkëkohore për një event të tillë. Ky event është mbështetur vjet për herë të parë nga Bashkia Maliq.Gjithashtu si një event i madh dhe i jashtëzakonshem ai mbështetet dhe nga MTKS dhe nga një sërë sponsorësh dhe donatorësh që e shoqërojnë me logjistikën e tyre promovuese në sheshet ku ky event zhvillohet. Për koncertin që duam të organizojmë në Maliq, kërkojmë mbështetjen tuaj si gjithmonë për vënien në dispozicion të hapësirave publike në sheshet kryesore, suportit për lidhje në rrjetin e energjisë elektrike 3 fazore si dhe mbështetjen financiare për një pjesë të preventivit të Eventit prej **1,000.000** (Njëmilionë) Lekë. Kostoja totale e gjithë eventit është **2,500.000** (Dymilionepesëqindmijë) Lekë. Pjesa tjetër e Produksionit prej **1,500.000** Lekësh mbulohet nga vetë Produksioni si dhe Sponsorë e Donatorë te ndryshëm.

Në pritje të marrjes në konsideratë të kërkesës sonë dhe koordinimit më tej, ju urojmë suksese të mëtejshme në punën tuaj

Me respekt,
Për PROMOTOR
Bledar LAÇO
Drejtor Ekzekutiv

SHOQATA ARTISTIKE KULTURORE
" PROMOTOR "
TIRANA - ALBANIA